LIGJ
Nr.8218, datë 16.5.1997

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7556, DATË 4.2.1992 "PËR ZGJEDHJET E KUVENDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8143, DATË 11.9.1996

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" me propozimin e një grupi deputetësh

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Neni 2, paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

"Të drejtën për t'u zgjedhur deputet në Kuvendin Popullor e kanë të gjithë ata që ditën e zgjedhjeve mbushin moshën 18 vjeç, kanë shtetësinë shqiptare, vendbanim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë për një periudhë kohe jo më pak se 6 muaj dhe përmbushin kërkesat e ligjit nr.8001, datë 22.9.1995 "Për genocidin dhe krimet kundër njerëzimit kryer në Shqipëri gjatë sundimit komunist për motive politike, ideologjike e fetare", ndryshuar me ligjin nr.8219, datë 13.5.1997, si dhe të ligjit nr.8043, datë 30.11.1995 "Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik ndryshuar me ligjin nr.8220, datë 13.5.1997."

Neni 2

Neni 3 ndryshohet si vijon:

"Nga e drejta e zgjedhjeve përjashtohen shtetasit, të cilëve u është hequr me vendim të Gjykatës zotësia për të vepruar, si dhe shtetasit që janë të arrestuar ose që janë duke vuajtur dënimin me burgim."

Neni 3

Neni 6 ndryshohet si vijon:

"Kuvendi Popullor përbëhet nga 155 deputetë, nga të cilët 115 zgjidhen drejtpërdrejtë në zona njëemërore, kurse 40 mandatet e tjerë shtesë u jepen kandidatëve që janë në listat e subjekteve në shkallë vendi, në bazë të votave të fituara gjatë votimit në raundin e parë, sipas rregullit të përcaktuar në nenin 11".

Neni 4

Neni 11 ndryshohet si vijon:

"Nga ndarja e 40 mandateve shtesë fitojnë vetëm subjektet që në shkallë vendi kanë jo më pak se 2 për qind të votave.

Pas numërimit të votave të vlefshme në shkallë vendi, të fituara nga çdo subjekt gjatë raundit të parë kryhen veprimet si më poshtë:

a) Numri i votave të vlefshme të secilës nga dy partitë që kanë fituar numrin më të madh të votave pjesëtohet me shumën e votave të vlefshme të tyre, dhe thyesa që del shumëzohet me numrin 10. Secila nga këto parti merr fillimisht aq vende sa është numri i plotë që del nga veprimet e kryera më sipër. Vendi që mbetet deri në plotësimin e numrit 10, i jepet subjektit që ka pjesën dhjetore më të madhe. Në rast barazimi përdoret shorti.

b) Numri i votave të vlefshme për secilin nga subjektet e tjera që plotësojnë kushtin e paragrafit të parë pjesëtohet me shumën e votave të vlefshme të tyre dhe thyesa që del shumëzohet me

numrin30. Secili nga këto subjekte merr fillimisht aq vende sa është numri i plotë që del nga veprimet e kryera më sipër. Vendet që ngelen deri në plotësimin e numrit 30 u shpërndahen këtyre subjekteve sipas madhësisë të pjesës dhjetore. Në rast barazimi përdoret shorti.

c) Caktimi i fituesve nga lista shumemërore bëhet sipas renditjes së tyre në listë. Kur numri i kandidatëve të listës është më i vogël se numri i vendeve që i takojnë asaj, atëherë fitues caktohet kandidati i paraqitur nga subjekti në njërën nga zonat e zgjedhjeve, i cili midis gjithë kandidatëve të këtij subjekti në zonat e zgjedhjeve, që nuk kanë fituar në zonat përkatëse dhe nuk figuron në listë, ka grumbulluar numrin më të madh të votave. Kur ka dy kandidatë të tillë përdoret shorti."

Neni 5

Në nenin 13 fjalët "jo më vonë se 30 ditë" bëhen "jo më vonë se 20 ditë".

Neni 6

Në paragrafin e parë të nenit 15 fjalët "jo më pak se 38 zona zgjedhjeje dhe në 12 rrethe të vendit" zëvendësohen me fjalët "jo më pak se 25 zona zgjedhjeje dhe në 10 rrethe të vendit".

Në paragrafin e fundit fjalët "jo më vonë se 30 ditë" bëhen "jo më vonë se 20 ditë".

Neni 7

Në nenin 16 fjalët "jo më vonë se 25 ditë" bëhen "jo më vonë se 17 ditë".

Neni 8

Në nenin 17 fjalia e dytë ndryshohet si vijon:

"Një kopje e këtij procesverbali, së bashku me deklaratën e kandidatit që pranon vënien e kandidaturës së tij në atë zonë, si dhe një kopje e shpalljes së kandidatëve në zonë i dërgohet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve brenda 2 ditëve nga data e shpalljes së tyre."

Neni 9

Neni 18 ndryshohet si vijon:

"Subjektet elektorale gëzojnë të drejtën për të bërë zëvendësimin e kandidatëve të propozuar prej tyre dhe për të bërë ndryshime në listat shumemërore që kanë paraqitur, deri 17 ditë para ditës së zgjedhjeve. Pas kalimit të këtij afati nuk lejohen që të bëhen ndryshime në to. Në rast se njëri nga kandidatët për deputetë në zonën njëemërore vdes pas kalimit të këtij afati, atëherë zgjedhjet për deputetë në këtë zonë zhvillohen jo më vonë se 9 javë pas datës së zgjedhjeve. Data e zhvillimit të këtyre zgjedhjeve caktohet nga Presidenti i Republikës."

Neni 10

Neni 19 ndryshohet si vijon:

"Pjesëtarët e forcave të armatosura, gjyqtarët dhe prokurorët, në rast se paraqesin kandidaturën për t'u zgjedhur deputetë, duhet të japin dorëheqjen dhe të largohen nga detyra".

Neni 11

Në nenin 21 në fund të paragrafit të tretë shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

"Ai detyrohet që jo më vonë se 2 ditë pas shpalljes së listave të zgjedhësve të sjellë në sekretariatin shtetëror të pushtetit lokal numrin e zgjedhësve për çdo zonë zgjedhjeje".

Në paragrafin e katërt fjalët "jo më vonë se 30 ditë" bëhen "jo më vonë se 17 ditë".

Neni 12

Neni 22 ndryshoht si vijon:

"Për zgjedhësit që shërbejnë dhe banojnë në njësitë e repartet ushtarake, listat e zgjedhësve hartohen dhe shpallen jo më vonë se 17 ditë përpara ditës së zgjedhjeve nga organet e përcaktuara në nenin 21, në territorin e të cilave ndodhet njësia ose reparti ushtarak, në bashkëpunim me komandat e tyre.

Të gjithë ushtarakët e tjerë regjistrohen në listat e zgjedhësve të vendbanimit të tyre".

Neni 13

Neni 31 riformulohet si vijon:

"Në fshatra, për çdo 100-1000 zgjedhës ngrihet një qendër votimi.

Në qytete e lagje qytetesh për çdo 800-1200 zgjedhës ngrihet një qendër votimi.

Për qytetet e lagjet e qyteteve që kanë më pak se 800 zgjedhës, ngrihet qendër votimi e veçantë. Për mbetjet më të mëdha se 400 zgjedhës, krijohet qendër votimi e veçantë, ndërsa mbetjet më të vogla i bashkohen qendrës së votimit më të afërt të komunës ose të bashkisë.

Kur një qendër banimi është larg nga qendra më e afërt e votimit më shumë se 3 km, aty ngrihet qendër votimi e veçantë, në qoftë se ka së paku 50 zgjedhës."

Neni 14

Neni 32 ndryshohet si vijon:

"Qendrat e votimit caktohen jo më vonë se 30 ditë para ditës së zgjedhjeve. Ato krijohen me vendim të organeve që shpallin listat e zgjedhësve, në përputhje me rregullat procedurale që ndiqen për shpalljen e listave të zgjedhësve."

Neni 15

Neni 34 ndryshohet si vijon:

"Për organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve funksionojnë:

a) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;

b) Komisionet e zgjedhjeve të zonave;

c) Komisionet e qendrave të votimit;

Komisionet e zgjedhjeve janë organizma të pavarur që në veprimtarinë e tyre i nënshtrohen vetëm ligjit. Veprimtaria e ushtruar prej anëtarëve të komisioneve është veprimtari shtetërore dhe jo politike. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre anëtarët e komisioneve gëzojnë imunitet. Partitë politike, në përputhje me rregullat e vendosura nga ky ligj, kanë të drejtë të kërkojnë zëvendësimin e përfaqësuesve të tyre në komisionet e zgjedhjeve, por ato nuk gëzojnë të drejtën që të urdhërojnë largimin e tyre nga komisionet.

Sekretarët e komisioneve të zgjedhjeve të zonave duhet të jenë juristë."

Neni 16

Neni 35 ndryshohet si vijon:

"Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Republikës së Shqipërisë është organ i përhershëm, i cili drejton dhe kontrollon zhvillimin e zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me dispozitat ligjore elektorale të shtetit shqiptar. Ai përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari, sekretari dhe 14 anëtarë.

Propozimet për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve i dërgohen Presidentit të Republikës nga partitë politike.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e ushtron veprimtarinë e tij për një periudhë 7-vjeçare. Anëtarët e tij gëzojnë të drejtën e riemërimit.

Partitë politike që nuk kanë anëtarë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kanë të drejtë të dërgojnë vëzhgues.

Neni 17

Pas nenit 35 shtohet neni 35a me këtë përmbajtje:

"Kryetari dhe zëvendëskryetari i Komisionit Qendror të Përhershëm të Zgjedhjeve propozohen përkatësisht nga partitë kryesore te "pozitës dhe të opozitës, të zgjedhur nga radhët e personelit shkencor universitar. Zëvendëskryetari gëzon pozitë juridike të barabartë me kryetarin. Në rast se ndonjëra nga këto parti nuk paraqet kandidaturë për kryetar ose zëvendëskryetar, atëherë ky vend i jepet partisë vijuese brenda grupimit pozitë-opozitë.

Sekretari i Komisionit është drejtori i drejtorisë së organizimit të zgjedhjeve dhe referendumeve në Sekretariatin eShtetit për Pushtetin Lokal.

Vendet e anëtarëve të komisionit ndahen në mënyrë të barabartë midis partive politike pjesëtare të koalicionit qeveritar dhe të opozitës. Brenda këtyre ndarjeve, vendet në komision zihen nga përfaqësuesit e partive politike në përpjesëtim me rezultatet e arritura prej tyre në zgjedhjet për organet e pushtetit lokal".

Neni 18

Pas nenit 35a shtohet neni 35b me këtë përmbajtje:

"Në rast se partia politike që bën pjesë në grupin e koalicionit qeveritar ose të opozitës largohet nga ky grup, atëherë edhe vendi ose vendet që i takojnë asaj në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve rishpërndahen brenda grupit përkatës në përputhje me kriterin e vendosur në paragrafin 3 të nenit 35a. Në rast se kjo parti ka arritur rezultate më të larta në zgjedhjet për organet e pushtetit lokal sesa ndonjëra nga partitë e grupit në të cilin ajo hyn dhe që kanë përfaqësues në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, atëherë partisë që largohet nga grupimi përkatës i garantohet vendi i anëtarit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, që i përket partisë që ka arritur rezultate më të ulëta në këto zgjedhje.

Pas përfundimit të zgjedhjeve për organet e pushtetit lokal, raportet e përfaqësimit të partive politike në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndryshojnë në përputhje me rezultatet e arritura prej tyre në këto zgjedhje.

Ndryshimet në përbërjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nuk mund të bëhen në 15 ditët e fundit përpara fillimit të zgjedhjeve."

Neni 19

Pas nenit 35b shtohet neni 35c me këtë përmbajtje:

"Kur partia politike, së cilës i takojnë vende në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nuk paraqet kandidatura për zënien e këtyre vendeve, atëherë vendet e caktuara për të zihen nga kandidatët e propozuar nga partitë e tjera politike sipas radhës së përcaktuar në bazë të kritereve të paragrafit 3 të nenit 35a, jo më vonë se 15 ditë para ditës së zgjedhjeve."

Neni 20

Neni 37 ndryshon si vijon:

"Në çdo zonë zgjedhjeje ngrihet komisioni i zgjedhjeve të zonës, i përbërë nga kryetari, zëvendëskryetari, sekretari dhe nga një përfaqësues nga çdo subjekt ose grupim elektoral që ka kandidat në atë zonë. Komisioni zgjedh nga radhët e tij sekretarin. Kryetari dhe zëvendëskryetari i komisionit të zgjedhjeve të zonës caktohen nga Presidenti i Republikës".

Propozimeve për anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve të zonës dërgohen në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve jo më vonë se 30 ditë para ditës së zgjedhjeve. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve miraton përbërjen e komisionit të zgjedhjeve të zonës jo më vonë se 28 ditë përpara ditës së zgjedhjeve."

Neni 21

Neni 39 ndryshohet si vijon:

"Në çdo qendër votimi ngrihet komisioni qendrës së votimit i përbërë nga kryetari, zëvendëskrytari, sekretari dhe një përfaqësues për çdo subjekt ose grupim elektoral që ka paraqitur kandidat për deputetë për zonën përkatëse.Përbërja e komisionit caktohet nga komisioni i zonës në përputhje me rregullin e vendosur për komisionin e zonës.

Propozimet për anëtarët e komisioneve të qendrave të votimit dërgohen në komisionin e zgjedhjeve të zonës jo më vonë se 15 ditë para ditës së zgjedhjeve. Kryesia e komisionit të zgjedhjeve të zonës shpall përbërjen e komisionit të qendrës së votimit jo më vonë se 10 ditë para ditës së zgjedhjeve."

Neni 22

Neni 40 ndryshohet si vijon:

"Komisioni i qendrës së votimit kryen këto detyra:

a) siguron zhvillimin e lirë dhe të qetë të zgjedhjeve në qendrën e votimit në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë ligj;

b) kujdeset për zbatimin me përpikmëri të procedurave të votimit;

c) regjistron zgjedhësit që paraqiten për të votuar me certifikatë për të drejtë vote dhe ata që paraqiten me vendim të gjykatës;

d) numëron votat e hedhura për çdo kandidat e listë shumemërore;

dh) përgatit dhe i dorëzon komisionit të zgjedhjeve të komunës ose të bashkisë procesverbalet e votimit të përcaktuara në këtë ligj;

e) mban procesverbal për ankesat dhe kërkesat e anëtarëve të komisionit e të zgjedhësve, i shqyrton ato dhe merr vendimin përkatës."

Neni 23

Neni 44 ndryshohet si vijon:

"Mbledhjet e komisioneve të zgjedhjeve janë të vlefshmet kur në to marrin pjesë më tepër se 1/2 e anëtarëve të tyre. Vendimet në këtë mbledhje merren me 2/3 e votave të anëtarëve të pranishëm dhe nënshkruhen nga kryetari e zëvendëskryetari. Mbledhjet e komisioneve të zgjedhjeve janë publike. Në të mund të marrin pjesë edhe vëzhgues, të cilët kanë të drejtë të bëjnë vërejtje. Me kërkesën e tyre vërejtjet shënohen në procesverbalin e mbledhjes së komisionit."

Neni 24

Në nenin 47 shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

"Personat që ndaj anëtarëve të komisioneve të zgjedhjeve, gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, kryejnë një nga veprat penale të përcaktuara në dispozitat e Kodit Penal, që përfshihen në kreun e krimeve kundër autoritetit të shtetit, dënohen me heqje lirie, në masën e caktuar prej këtyre dispozitave.

Personat që bëjnë pjesë në komisionet e zgjedhjeve, mbajnë përgjegjësi ligjore për zbatimin e dispozitave të këtij ligji."

Neni 25

Neni 53 ndryshohet si vijon:

"Fushata elektorale në Radiotelevizionin Shtetëror bëhet në emisione të posaçme. Partive, të cilat në zgjedhjet e fundit për këshillat e rretheve kanë fituar më shumë se 0,50 për qind të votave, u vihen në dispozicion një kohë e përgjithshme transmetimit prej 4 orësh, gjysma e së cilës u takon partive të koalicionit qeveritar dhe gjysma tjetër partive të opozitës. Kjo kohë ndahet midis tyre në përputhje me përqindjen e votave të fituara në ato zgjedhje, por jo më pak se 15 minuta për një subjekt. Të gjitha partive të tjera politike, që marrin pjesë në zgjedhje, u vihen në dispozicion nga 10 minuta.

Platforma dhe programi i transmetimeve elektorale, që do të vihen në dispozicion të partive politike për fushatën elektorale, miratohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Çdo kohë shtesë që

Radioelevizioni Shtetëror mund të vërë në dispozicion për debate elektorale ose për fushatën elektorale të partive, ndahet sipas raporteve të përcaktuara në paragrafin e mësipërm.

Për raundin e dytë, hapësira e vënë në dispozicion të subjekteve elektorale, në përputhje me rregullin e mësipërm, përgjysmohet.

Për të mbikëqyrur zbatimin rigoroz të kohës, krijohetkomisioni mbikëqyrës i mediave elektronike, i cili është përgjegjëspër të gjitha programet, jo vetëm për ato që lidhen me fushatën elektorale, por edhe për lajmet, informacionet politike etj. Komisioni përbëhet nga një përfaqësues për çdo parti që bën pjesë në Qeverinë e Pajtimit Kombëtar. Kryetari e zëvendëskryetari përfaqësojnë përkatësisht partinë më të madhe të pozitës dhe të opozitës. Ata bashkëdrejtojnë veprimtarinë e Komisionit. Komisioni ngre një zyrë të tijën në godinën e Televizionit Shtetëror, gëzon të drejtën për të marrë pjesë në mbledhjet e redaksive dhe për veprimtarinë e tij përgjigjet drejtpërdrejt para Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve organizon në Radiotelevizionin Shqiptar emisione për edukimin elektoral të popullsisë, duke përjashtuar qëndrimet partiake."

Neni 26

Neni 54 paragrafi i dytë riformulohet si vijon:

"Materialet propagandistike mund të afishohen në vendet publike, të cilat duhet të caktohen nga organet e pushtetit lokal, duke siguruar mundësi të barabarta propagandimi për çdo subjekt elektoral."

Neni 27

Neni 56 shfuqizohet.

Neni 28

Neni 58 ndryshohet si vijon:

"Këshilli i Ministrave cakton fonde nga buxheti për fushatën elektorale të partive politike.

Shuma e akorduar nga buxheti i shtetit për partitë politike që marrin pjesë në zgjedhje, u jepet këtyre partive në përputhje me përqindjen e votave që do të fitojnë në zgjedhje. Nuk përfitojnë nga ky rregull partitë politike që, në shkallë vendi, nuk arrijnë të fitojnë 2 për qind të votave.

Këshilli i Ministrave u cakton një shumë të hollash në formë paradhënie partive që në zgjedhjet e fundit të pushtetit lokal kanë fituar më shumë se 1 për qind të votave për këshillin e rrethit. Pas përfundimit të zgjedhjeve, kur partitë politike që kanë përfituar shuma të tilla nuk përmbushin kushtet e paragrafit të mësipërm, atëherë ato detyrohen të kthejnë shumat e dhëna në paradhënie ose pjesët e tepërta të këtyre shumave."

Neni 29

Paragrafi i fundit i nenit 61 ndryshohet si vijon:

"Nuk u ruhet vendi i punës gjyqtarëve, prokurorëve dhe pjesëtarëve të forcave të armatosura."

Neni 30

Neni 63 riformulohet si vijon:

"Votimi për deputetët e Kuvendit Popullor bëhet në mjedise të caktuara nga organet ekzekutive të pushtetit lokal. Në të nuk lejohet asnjë material propagandistik apo fushate partiake.

Ndalohet përdorimi si qendra votimi i godinave të partive politike, të subjekteve të tjera elektorale, si dhe i institucioneve shtetërore të depolitizuara, me përjashtim të shkollave."

Neni 31

Neni 64 ndryshohet si vijon:

"Votimi për zgjedhjet e Kuvendit Popullor bëhet në një ditë pushimi për gjithë vendin.

Votimi fillon në orën 8^{00} dhe mbyllet në orën 21^{00}. Në qoftë se para orës 21^{00} ka ende njerëz që presin të votojnë, votimi vazhdon derisa të mbarojnë të gjithë të pranishmit.

Në ditën e votimit komisioni i qendrës së votimit e fillon punën në orën 7^{00}, duke bërë kontrollin e kutisë së votimit. Pas kësaj kutia mbyllet dhe vuloset me vulën e qendrës së votimit, e cila mbahet në ruajtje.

Kryetari i komisionit të qendrës së votimit, në prani të komisionit, vulos të gjitha fletët e votimit, numri i të cilave shënohet në procesverbalin që firmoset nga të gjithë anëtarët e pranishëm të komisionit.

Pas vulosjes, kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari, në prani të anëtarëve të komisionit, firmosin fletët e votimit.

Pas kryerjes sipas radhës të veprimeve të përmendura më sipër, kryetari i komisionit të qendrës së votimit deklaron fillimin e votimit."

Neni 32

Paragrafët 2 dhe 3 të nenit 65 ndryshohen si vijon:

"Komisioni i qendrës së votimit është i detyruar të vërtetojë identitetin e zgjedhësve që marrin pjesë në votim. Për vërtetimin e identitetit të tyre, ai ka të drejtë t'u kërkojë zgjedhësve që të paraqesin, sipas rastit, letërnjoftimet, pasaportën për jashtë shtetit, librezën ushtarake ose një certifikatë me fotografi."

Neni 33

Në nenin 66, paragrafi i tretë, rreshti i fundit, formulohet si vijon:

"Në këto raste merret leje nga kryetari dhe zëvendëskryetari i komisionit të qendrës së votimit dhe kjo shënohet në listën e zgjedhësve."

Në paragrafin e katërt, rreshti i fundit të shtohen fjalët:

"Për fletëvotimet e grisura mbahet procesverbal."

Paragrafi gjashtë riformulohet si vijon:

"Në qoftë se është e nevojshme për të vendosur rregull në qendrën e votimit dhe për të siguruar zhvillimin e qetë dhe të lirë të votimit, kryetari e zëvendëskryetari i komisionit të qendrës së votimit, me vendim unanim të protokolluar, mund të kërkojnë ndihmën e organeve të policisë, të cilët në këtë rast janë të detyruar të kryejnë vetëm ato veprime dhe të marrin vetëm ato masa që i kërkohen. Në rast se nuk arrihet unanimiteti midis tyre dhe nga komisioni çmohet se është e nevojshme ndihma e organeve të policisë, atëherë vendimi merret me shumicë vote prej 2/3 të anëtarëve të pranishëm të komisionit."

Neni 34

Neni 67 ndryshohet si vijon:

"Votimi kryhet sipas modeleve të fletëvotimeve që caktohen nga Këshilli i Ministrave. Fletëvotimet janë të njëjta në formë, madhësi, ngjyrë e përbërje të letrës. Komisioneve të zgjedhjeve të zonave, fletëvotimet u jepen në numër 10 për qind më të madh se numri i zgjedhësve të regjistruar në listat përkatëse të zgjedhësve në ditën e shpalljes së tyre."

Neni 35

Neni 68 ndryshohet si vijon:

"Fletëvotimi është i ndarë në mënyrë të qartë në dy pjesë. Në pjesën e majtë janë votat për kandidatin për deputet, ndërsa në pjesën e djathtë janë votat për subjektet elektorale. Në pjesën e majtë shënohen për çdo kandidat sigla e subjektit, emri, aftësia dhe mbiemri i kandidatit dhe emërtimi i subjektit të cilit i përket ai. Për kandidatët e pavarur shkruhen fjalët "kandidat i pavarur". Në pjesën e djathtë shënohen siglat dhe emërtimet e subjekteve që marrin pjesë në ndarjen e mandateve shtesë me siglën sipas rendit alfabetik të subjekteve. Në të dy pjesët e fletëvotimit renditja bëhet sipas rendit

alfabetik të subjektit elektoral.

Si në pjesën e majtë, ashtu dhe në pjesën e djathtë të fletëvotimit, në fillim të çdo rreshti, me të dhënat e përmendura më sipër, ka një ndarje në të cilën zgjedhësi bën shënimin përkatës për kandidatin ose për subjektin elektoral për të cilin voton. Në këtë ndarje zgjedhësi mund të vendosë shenjën matematikore të mbledhjes (+), të shumëzimit (X) ose të zbritjes(-)".

Neni 36

Neni 69 ndryshohet si vijon:

"Gjatë kontrollit dhe numërimit të fletëve të votimit, sipas nenit 64 të këtij ligji, komisioni i qendrës së votimit, kur vëren se midis fletëve të votimit të marra në dorëzim ka fletë votimi, të cilat nuk i përgjigjen kërkesave për formën, madhësinë, ngjyrën, përbërjen e letrës dhe përmbajtjen, i nxjerr ato jashtë përdorimit, duke shënuar në secilën prej tyre fjalët "jashtë përdorimit".

Ky rregull zbatohet edhe për fletët e votimit që janë të grisura a të dëmtuara ose që gjatë zhvillimit të procesit të votimit grisen apo dëmtohen, si dhe për fletët e votimit të plotësuara gabim.

Këto fletë votimi mbahen në ruajtje nga ana e komisionit dhe numri i tyre regjistrohet në procesverbalin përfundimtar.

Fletët e votimit të gjetura brenda në kuti pas përfundimit të votimit, kur nuk u përgjigjen kërkesave për formën, madhësinë, ngjyrën, përbërjen e letrës, përmbajtjen, si dhe kur nuk përmbajnë vulën dhe nënshkrimet sipas nenit 64, quhen fletëvotimi të parregullta. Numri i tyre shënohet në procesverbalin përfundimtar dhe këto fletëvotimi ruhen veçmas."

Neni 37

Shkronja "b" e nenit 73 ndryshohet si vijon:

"Bëhet numërimi i fletëve të votimit të gjetura në kuti, numërohen fletët e votimit që janë vlerësuar të parregullta, numërohen fletët e votimit që janë vlerësuar të rregullta të pavlefshme dhe në fund numërohen fletët e votimit që janë vlerësuar të rregullta, të vlefshme për secilin dhe kandidatët ose subjektet."

Neni 38

Neni 74 ndryshohet si vijon:

"Fletëvotimet e rregullta të gjetura brenda në kuti janë të vlefshme dhe llogariten si vota për kandidatët ose subjektet që marrin pjesë në zgjedhjet për Kuvendin Popullor, vetëm në qoftë se votuesit në fletët e votimit kanë vënë shenjën vetëm në njërin nga kandidatët ose subjektet elektorale të paraqitura në fletën e votimit.

Në çdo rast tjetër fletëvotimet e rregullta quhen fletëvotimi të rregullta të pavlefshme. Fletët e votimit quhen të tilla edhe në rastet kur zgjedhësi, pavarësisht se ka vënë shenjën për njërin nga kandidatët ose subjektet, ka bërë shënime të tjera shtesë në të.

Vlerësimi i votës bëhet nga komisioni i qendrës së votimit. Votat e diskutueshme fillimisht shqyrtohen dhe pastaj vlerësohen.

Çdo kundërshtim nga anëtarët e komisionit shënohet në procesverbal dhe këto fletëvotimi ruhen veçmas."

Neni 39

Neni 75 ndryshohet si vijon:

"Në përfundim të voimit, numërimit dhe vlerësimit të fletëve të votimit, kryesia e komisionit të qendrës së votimit harton procesverbalin përkatës.

Procesverbali do të përmbajë:

1. Numrin e zonës dhe numrin e qendrës së votimit.
2. Kohën e fillimit dhe përfundimit të votimit.
3. Numrin e zgjedhësve në listën e zgjedhësve.
4. Numrin e zgjedhësve në listën shtesë.

5. Numrin e votuesve sipas shënimeve në listat e zgjedhësve.
6. Numrin e fletëvotimeve të marra në dorëzim.
7. Numrin e fletëvotimeve të nxjerra jashtë përdorimit përpara dhe gjatë procesit të votimit.
8. Numrin e fletëvotimeve të papërdorura.
9. Numrin e fletëvotimeve të gjetura brenda në kuti.
10. Numrin e fletëvotimeve të parregullta.
11. Numrin e fletëvotimeve të rregullta.
12. Numrin e fletëvotimeve të rregullta të pavlefshme.
13. Numrin e fletëvotimeve të rregullta të vlefshme për secilin nga kandidatët ose subjektet.
14. Numrin e kopjeve, në të cilat është hartuar procesverbali.
15. Vërejtjet e ndryshme të motivuara të anëtarëve dhe të vëzhguesve të veçantë dhe vendimet e marra për to.

Të dhënat e pikave nga "3" deri në "14" jepen me shifra dhe fjalë.

Procesverbali firmoset nga kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari i komisionit të qendrës së votimit dhe duhet të përmbajë vulën përkatëse.

Çdo anëtar i komisionit të qendrës së votimit është i detyruar të firmosë kopjet e procesverbalit. Ai ka të drejtë të shkruajë në procesverbal të gjitha vërejtjet dhe pranë nënshkrimit të tij të shënojë fjalët "me vërejtje". Në qoftë se njëri nga anëtarët e komisionit nuk pranon të nënshkruajë procesverbalin, atëherë mungesa e nënshkrimit të tij nuk e bën atë të pavlefshëm. Ky rregull zbatohet edhe për komisionin e zgjedhjeve të zonës.

Çdo anëtar i komisionit që ka nënshkruar, ka të drejtë të marrë kopje të procesverbalit.

Menjëherë pas nxjerrjes së rezultateve të votimit, komisioni i qendrës së votimit bën afishimin e tyre në një vend të dukshëm jashtë mjedisit të qëndrës së votimit."

Neni 40

Paragrafi i dytë i nenit 76 rifomulohet si vijon:

"Të gjitha këto materiale dorëzohen personalisht nga kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari i komisionit të qendrës së votimit së bashku me cilindo nga përfaqësuesit e subjekteve elektorale, brenda 24 orëve nga mbyllja e votimit."

Neni 41

Neni 77 ndryshohet si vijon:

"Komisioni i zgjedhjeve të zonës nxjerr rezultatin e votimeve në bazë të të dhënave të procesverbaleve të qëndrave të votimit dhe i shpall ato në formën e një procesverbali i cili duhet të përmbajë:

1. Numrin e zonës dhe numrin e qendrave të votimit.
2. Numrin e zgjedhësve në listat e zgjedhësve.
3. Numrin e zgjedhësve në listat shtesë.
4. Numrin e votuesve sipas shënimeve në lista.
5. Numrin e fletëvotimeve të marra në dorëzim nga komisionet e qendrave të votimit.
6. Numrin e fletëvotimeve të nxjerra jashtë përdorimit përpara dhe gjatë procesit të votimit.
7. Numrin e fletëvotimeve të papërdorura.
8. Numrin e fletëvotimeve të gjetura brenda në kuti.
9. Numrin e fletëvotimeve të parregullta.
10. Numrin e fletëvotimeve të rregullta.
11. Nurin e fletëvotimeve të rregullta të pavlefshme.
12. Numrin e fletëvotimeve të rregullta të vlefshme për sejcilin nga kandidatët ose subjektet.
13. Numrin e kopjeve, në të cilat është hartuar procesverbali.
14. Vërejtjet e ndryshme të motivuara të anëtarëve dhe të vëzhguesve të veçantë dhe vendimet e marra për to.
15. Procesverbali për rezultatet e votimit për kandidatët në zonën njëemërore do të përmbajë edhe emrin, atësinë dhe mbiemrin e kandidatit që fiton; kur duhet të bëhet raundi i dytë emrin, atësinë dhe mbiemrin për dy kandidatët e parë.

Të dhënat e pikave nga "2" deri në "13" jepen me shifra dhe fjalë.

Menjëherë pas nxjerrjes së rezultatit të votimit, komisioni I zgjedhjeve i zonës bën afishimin e tyre në një vend të dukshëm jashtë mjediseve të këtij komisioni."

Neni 42

Neni 78 ndryshohet si vijon:

"Komisioni i zgjedhjeve i zonës dërgon në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve procesverbalet dhe materialet e tjera të zgjedhjeve brenda 24 orëve nga marrja e rezultatit nga të gjitha qendrat e votimit. Kopjet e procesverbalit të rezultateve të votimit në qendrat e votimit u kthehen këtyre të fundit.

Dorëzimi i materialeve të mësipërme bëhet nga kryetari, zëvendëskryetari, sekretari dhe çdo përfaqësues subjekti elektoral që dëshiron.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të deklarojë në shkallë kombëtare publikisht rezultatet nga zonat jo më vonë se 72 orë pas raportit përfundimtar të komisionit elektoral të zonës.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve gjithashtu do të publikojë një buletin që përmban komplet rezultatet e zgjedhjeve nga qendrat e votimit jo më vonë se 30 ditë pas deklarimit zyrtar të rezultateve."

Neni 43

Në fillim të nenit 89 pas fjalës "vëzhgues" shtohet fjala "të huaj".

Paragrafi i dytë i nenit 89 riformulohet:

"Përfaqësuesit e shteteve anëtare të OSBE-së, të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, të Parlamentit Europian dhe të organizmave të tjerë që lidhen me çështjen e të drejtave të njeriut."

Neni 44

Në nenin 92 të shtohen dy paragrafe me këtë përmbajtje:

"Komisioni Qendror i Zgjedhjeve cakton një të dërguar në drejtorinë e organizimit të zgjedhjeve dhe referendumeve në Sekretariatin e Pushtetit Lokal.

Organet e administratës shtetërore kanë për detyrë të marrin të gjitha masat përgatitore, administrative e logjistike në shërbim të zgjedhjeve në përputhje me kërkesat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve e komisionet e zonave të zgjedhjeve."

Neni 45

Dispozitë kalimtare

Për efekt të zbatimit të dispozitave të këtij ligji në zgjedhjet e para pas hyrjes në fuqi të tij, raporti pozitë-opozitë do të përcaktohet në bazë të raporteve politike përpara datës 9 mars 1997. Po kështu, ndarja e zonave të zgjedhjeve do të jetë e njëjtë me atë të fundit për Kuvendin Popullor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përbërja dhe funksionimi i të cilit është përcaktuar me ligjin nr.8144, datë 11.9.1996 "Për miratimin me disa shtesa e ndryshime të dekretit nr.1579, datë 13. 8.1996 "Për ndërtimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Shqipërisë", i cili do të "krijohet e do të vazhdojë funksionimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji".

Neni 46

Dispozitat e ligjit nr.8144, datë 11.9.1996 "Për miratimin me disa shtesa e ndryshime të dekretit nr.1579, datë 13.8.1996 "Për ndërtimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Shqipërisë" që përcaktojnë modalitetet e ndërtimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, shfuqizohen.

Neni 47

Ky ligj hyn në fuqi më datën 16.5.1997

Shpallur me dekretin nr.1795, datë 16.5.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha